



## **Rindërtimi i lokacioneve Ortodokse Serbe në Kosovë – Sekretari Gjeneral Terry Davis**

Jam shumë i befasuar me atë që Kryepeshkopi Artemije dhe disa përfaqësues të autoriteteve serbe si duket kanë thënë në konferencën për shtyp të mbajtur dje në Beograd. Kritikrat e tyre mbi rindërtimin e lokacioneve Ortodokse Serbe në Kosovë është në kundërshtim të qartë me mirënjohjen e shprehur mua nga ana e autoriteteve serbe gjatë vizitës sime së fundit në Beograd. Ndoshta më duhet ta bëjë të qartë se unë nuk kam asnjë shënim të çfarëdo ankese nga asnjë zyrtar serb te Këshilli i Evropës, dhe unë kam pritur se ata së pari do të bisedojnë me neve para se të bëjnë kritika të tilla të pabaza, posaçërisht duke pasur parasysh që Serbia është anëtare e Këshillit të Evropës.

Arsyeja e vetme e përfshirjes tonë gjithmonë ka qenë riparimi, sa më i shpejtë që të jetë i mundur, i lokacioneve religjioze të cilat janë dëmtuar në trazirat 3 vjet më herët. Besoj se jemi duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në rindërtimin e monumenteve Ortodokse Serbe në Kosovë. Ne jemi gati të vazhdojmë, por ne nuk do t'ju imponohemi nëse ndihma jonë nuk dëshirohet. Personalisht do të ndjihesha keq, sepse Serbia është pjesë e Evropës dhe trashëgimia religjioze dhe kulturore serbe është pjesë e trashëgimisë evropiane si tërësi.